



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KODI

Testimi i kandidatëve për Shërbimin psiko-
social në IPAP (Profili Psikolog)

E Martë, 14 Dhjetor 2021
Ora 10.00

Për t' u plotësuar nga Komisioni i Vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikë										

Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikë										

Pyetja	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
Pikë										

Pyetja	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
Pikë										

Rubrika	Nr. i pikëve sipas rubrikave	Pikë të fituara
Me alternativa (40pyetje*1 pikë)	40	
Totali	40	

Komisioni i vlerësimit (Emri, Mbiemri, Firma)

Pyetja 1

Dy fushat nga të cilat varet psikologjia shkollore janë:

- A) Zhvillimi dhe Edukimi
- B) Edukimi dhe Psikologjia**
- C) Psikologjia dhe Zhvillimi
- D) Shëndeti mendor dhe të nxënës

PS)B

Pyetja 2

Faktorët që influencojnë në ushtrimin e profesionit të psikologut shkollore janë:

- A) Kushtet lokale të punësimit, legjislacioni dhe financimi**
- B) Legjislacioni, dhe Financimi
- C) Financimi dhe Kushtet lokale
- D) Kushtet lokale dhe Legjislacioni

PS)A

Pyetja 3

Raporti i shkruar mbi vlerësimin psikologjik të nxënësit, i cili hartohet për të siguruar informacione më teknike, të cilat duhet të ndahen vetëm me profesionistët quhet:

- A) Raport i integruar
- B) Raport ekzaminues
- C) Raport këshillues**
- D) Raport shpjegues

PS)C

Pyetja 4

Cili nga modelet e mëposhtme evidenton nevojën për të ndërmarrë ndryshime që kanë të bëjnë me gjithë shkollën:

- A) Modeli i konsultimit të shëndetit mendor
- B) Modeli i konsultimit bihevioral
- C) Modeli i konsultimit të krizave
- D) Modeli i konsultimit organizacional**

PS)D

Pyetja 5

Dokumenti themelor i kurrikulës është:

- A) Kurrikula bërthamë
- B) Korniza kurrikulare**

- C) Programet mësimore
- D) Vlerësimi

PS)B

Pyetja 6

Cila nga kompetencat e mëposhtme bën pjesë në kompetencat themelore të përshkruara në Ligjin nr.69, date 21.6.2012 i ndryshuar me ligjin nr.56/2015,datë 28.5.2015:

- A) Kompetencën për jetën
- B) Kompetencën për sipërmarrjen
- C) **Kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**
- D) Kompetencën për jetën dhe mjedisin

PS)C

Pyetja 7

Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranoen nxënës të moshës:

- A) jo më të madhe se shtatëmbëdhjetë vjeç
- B) jo më të madhe se njëzet vjeç
- C) jo më të madhe se njëzet e një vjeç
- D) **jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç**

PS)D

Pyetja 8

Të dhënat personale të një grupi personash mund t'u vihen në dispozicion institucioneve të tjera për studime, pa zbuluar identitetin e tyre vetëm pas miratimit me shkrim:

- A) **Të drejtorit të institucionit arsimor,**
- B) Të prindërve
- C) Të nxënësve
- D) Të njësisë arsimore vendore

PS)A

Pyetja 9

Në rastet kur shkollat janë me numër të vogël nxënësish një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri i nxënësve do të jetë:

- A) 400 nxënës,
- B) 800 nxënës
- C) 1300 nxënës
- D) **500 – 700 nxënës**

PS)D

Pyetja 10

Punonjësi psiko-social ka për detyrë të njoftojë për të dhënat që grumbullon për nxënësin:

- A) Drejtuesit e IA-së
- B) Mësuesin kujdestar dhe drejtuesit e IA-së**
- C) Prindin
- D) Mësuesin kujdestar

PS)B

Pyetja 11

Dosja e nxënësit e hartuar nga psikologu/punonjësi social mund të lexohet përveç se nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore edhe nga nxënësi i moshës:

- A) 15 vjeç
- B) 14 vjeç
- C) 17 vjeç**
- D) 16 vjeç

PS)C

Pyetja 12 V)1

Oficeri i sigurisë zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve:

- A) Vetëm në raste emergjente ose me vendim nga drejtorja e IA-së**
- B) Kur kërkohet nga bordi i prindërve
- C) Me kërkesë të mësuesit kujdestar
- D) Me vendim nga drejtorja e IA-së

PS)A

Pyetja 13

Ndërhyrja duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata në rastet:

- A) e rrezikut të ulët
- B) e rrezikut të lartë
- C) e rrezikut të mesëm
- D) e rrezikut të menjëhershëm**

PS)D

Pyetja 14

Vlerësimi fillestar i nivelit të rrezikut kryhet pas raportimit:

- A) maksimalisht brenda 24 orëve
- B) maksimalisht brenda 48 orëve**
- C) minimalisht brenda 48 orëve
- D) minimalisht brenda 36 orëve

PS)B

Pyetja 15

Cili është afati kohor pas hartimit të planit të parë, gjatë të cilit punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, sipas rastit ose kërkesës së njërit prej anëtarëve të Grupit teknik ndërsektorial ka detyrimin të bëjë rishqyrtimin e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës në nevojë:

- A) të paktën 2 javë
- B) të paktën 4 javë
- C) të paktën 6 javë**
- D) të paktën 8 javë

PS)C

Pyetja 16

Përshkrimi i gjendjes së shërbimit psikologjik për secilën fushë të shërbimit psikologjik i referohet:

- A) Standardit të vlerësimit**
- B) Shkallës së vlerësimit
- C) Instrumentit të vëzhgimit
- D) Treguesit të vlerësimit

PS)A

Pyetja 17

Cilët janë mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucional në nivel vendor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës:

- A) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- B) Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës
- C) Bashkia
- D) Grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative**

PS)D

Pyetja 18

Përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave në politikë i referohet:

- A) Radikalizimit në dhunë
- B) Ekstremizmit të dhunshëm**
- C) Kundëradikalizimit
- D) Qëndresës

PS)B

Pyetja 19

Mësuesit kanë pritshmëri të larta për arritjet shkollore apo dhe në fusha të tjera të çdo nxënësi. Cilës prej vlerave të mëposhtme që shërbejnë si baza për punën e të gjithë mësuesve në arsimin gjithëpërfshirës i referohet ky përkufizim:

- A) Vlerësimi i diversitetit të nxënësit
- B) Bashkëpunimi me të tjerët
- C) Mbështetja e të gjithë nxënësve**
- D) Vazhdimësia e zhvillimit profesional individual

PS)C

Pyetja 20

Reforma arsimore krijon kushtet që nxënësit të ndërtojnë njohuri të reja e kompetenca dhe të aftësohen për t'iu përgjigjur zhvillimit të vendit dhe ndryshimeve në tregun e punës. Cilit prej parimeve udhëheqëse të Strategjisë së zhvillimit të Arsimit Parauniversitar i përket ky pohim:

- A) Arsim për jetën**
- B) Mbështetje komunitare
- C) Sistem arsimor i njësuar
- D) Sistem arsimor i panjësuar

PS)A

Pyetja 21

Psikologët shkollore marrin pëlqim me shkrim ose jo për të ofruar shërbime për nxënësit. Kjo ka të bëjë me:

- A) Parimin e konfidencialitetit
- B) Parimin e pëlqimit të informuar**
- C) Parimin e konfliktit të interesit
- D) Parimi i kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë

PS)B

Pyetja 22

Në rastin kur shkolla konsiderohet një sistem, cila prej alternativave të mëposhtme nuk ka të bëjë me suprasistemet (faktorët fizikë dhe socialë të jashtëm për kufijtë e sistemit):

- A) Njësia administrative
- B) Komuniteti lokal
- C) Klasa**
- D) Politikat e mirëqenies së fëmijëve

PS)C

Pyetja 23

Cili prej pohimeve të mëposhtme është i gabuar?

- A) Psikologu luan rolin e menaxherit të rastit për fëmijën, kur shkolla nuk ka punonjës social.
- B) Psikologu luan rolin e pikës së kontaktit për shkëmbimin e informacionit me institucionet e tjera për fëmijën, kur shkolla nuk ka punonjës social.
- C) Psikologu realizon koordinimin me institucionet e tjera që ofrojnë mbështetje për fëmijën dhe familjen, kur shkolla nuk ka punonjës social.
- D) Psikologu realizon koordinimin me institucionet e tjera që ofrojnë mbështetje për fëmijën dhe familjen, edhe kur shkolla ka punonjës social.**

PS)D

Pyetja 24

Shkollat si qendër komunitare, funksionojnë bazuar në:

- A) Plane të gatshme
- B) Standarde**
- C) Objektiva afatshkurtër
- D) Objektiva afatgjatë

PS)B

Pyetja 25

Cili prej pohimeve të mëposhtme është i gabuar?

- A) Bullizmi në shkollë ndikon në shëndetin mendor të nxënësit.
- B) Bullizmi në shkollë ndikon në performancën akademike të nxënësit.
- C) Bullizimi në shkollë nuk ndikon në shëndetin fizik të nxënësit.**
- D) Bullizimi në shkollë ndikon në gjendjen emocionale të nxënësit.

PS)C

Pyetja 26

Në raportin e një vlerësimi psikologjik përfshihen të gjitha alternativat më poshtë përveç:

- A) Procedurat e vlerësimit
- B) Sjelljet përgjatë procesit të vlerësimit
- C) Përmbledhje dhe rekomandime
- D) Seancat e këshillimit psikologjik**

PS)D

Pyetja 27

Cila prej masave të mëposhtme nuk ndikon në krijimin e sfondit të nevojshëm që masat antibullizëm të jenë të suksesshme në shkollë.

- A) Masat për të rritur performancën akademike të nxënësve.
- B) Masat që nxisin kulturën gjithëpërfshirëse të shkollës.
- C) Masat që nxisin mosdiskriminimin në shkollë.
- D) Masat që promovojnë kulturën demokratike në shkollë.

PS)A

Pyetja 28

Rezultatet e pritshme të nxënësit bazuar në pesë fushat e zhvillimit të përfshira në Planin Edukativ Individual (PEI) rishikohen:

- A) Çdo 1 muaj
- B) Çdo 3 muaj**
- C) Çdo 6 muaj
- D) Çdo 1 vit

PS)B

Pyetja 29

Detyrimi i fëmijëve të zbatojnë rregulla jo logjike - "Thjesht, sepse kështu them unë" - pra kështu thotë adulti (mësuesi/prindi) ka të bëjë me:

- A) Dhunë fizike
- B) Dhunë psikologjike**
- C) Disiplinim
- D) Neglizhim

PS)B

Pyetja 30

Përdorimi i shpërblimeve tek nxënësit:

- A) Duhet të jetë i fokusuar tek shpërblimet materiale
- B) Duhet të jetë i vazhdueshëm
- C) Duhet të jetë konsistent
- D) Duhet të jetë i ndryshueshëm**

PS)D

Pyetja 31

Cila është një nga karakteristikat e vendit të punës që ndikojnë në performancën që shfaq psikologu shkollor:

- A) Ndryshimet social kulturore
- B) Karakteristikat profesionale

- C) Koha e punës së psikologut shkollor
- D) Karakteristika personale

PS)A

Pyetja 32

Cilët nga psikologët i ndihmojnë fëmijët – nxënës që të njohin fuqitë dhe burimet që mund të kenë për të reduktuar shqetësimet e tyre:

- A) Psikologët e edukimit
- B) Psikologët shkollorë
- C) Psikologët këshillues
- D) Psikologët organizacionalë

PS)C

Pyetja 33

Me cilin prej fokuseve të punës së psikologut shkollor ka të bëjë vlerësimi i efektivitetit të programeve akademike:

- A) Edukimin
- B) Parandalimin
- C) Konsultimin
- D) Kërkimin dhe planifikimin

PS)D

Pyetja 34

A janë procedurat e vlerësimit në gjendje që të rrisin aftësinë e personelit të shkollës për të identifikuar nxënësit me probleme? Kjo pyetje na ndihmon për të ndërmarrë:

- A) Vendimet e preferuara për klasën
- B) Vendimet e preferuara për fëmijën
- C) Vendimet në klasë
- D) Vendimet në rezultate

PS)B

Pyetja 35

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi është detyrë e:

- A) Njësisë bazë të qeverisjes vendore

- B) Inspektoratit shtetëror të arsimit
- C) Ministrisë së Arsimit
- D) Njësisë arsimore vendore

PS)A

Pyetja 36

Kontribuimi në mbarëvajtjen e institucionit është një detyrë e:

- A) Nxënësit
- B) Mësuesit
- C) Prindit
- D) Drejtorit të institucionit arsimor

PS)C

Pyetja 37

Bazuar në Rregullore për IAP-t 2020 nxënësi mbetet në klasë kur është:

- A) jokalues në të paktën 4 lëndë
- B) jokalues të paktën në një lëndë në sesionin e parë
- C) jokalues në të paktën 2 lëndë
- D) jokalues të paktën në një lëndë në sesionin e dytë

PS)D

Pyetja 38

Në njërën prej seancave të këshillimit nxënësi shprehet se për shkak të depresionit që ai ka në pjesën më të madhe të kohës, përpiqet që të shmangët nga përballimi i vështirësive në jetë apo çfarëdolloj gjëje që mund ta bënte të ndihej më në depresion. Ai dëshiron që të ndihet i gëzuar, por ka frikë që të ndërmarrë hapa për këtë gjë. Pas përfundimit të kësaj seance psikologu referon rasti tek një profesionist i fushës, pasi e ndien që nuk ka eksperiencën e kompetencën e duhur për tu marrë me këtë rast. Bazuar në dokumentin e Inspektimit dhe vetëvlerësimit në shkollë i psikologut shkollor ky veprim i psikologut reflekton:

- A) Njohjen e limiteve të këshillimit
- B) Zotërimin e koncepteve të qarta të këshillimit
- C) Shkathtësi specifike për këshillim
- D) Zotërimin e një etike përparuese këshilluese

PS)D

Pyetja 39

Ju kërkohet të hartoni një plan sigurie të IA-së, për të përcaktuar rreziqet e mundshme e daljet emergjente, duke minimizuar kështu burimet e aksidenteve. Si do të vepronit:

- A) Do e realizonit në bashkëpunim me mësuesit
- B) Do ia linit në dorë oficerit të sigurisë, pasi nuk është detyrë e juaja
- C) Do e realizonit në bashkëpunim me bordin e shkollës
- D) Do e realizonit në bashkëpunim me këshillin e prindërve

PS)B

Pyetja 40

Gjatë punës tuaj ndieni që mësuesit dhe aktorë të tjerë në shkollë mbajnë qëndrime diskriminuese ndaj jush. Nga do ta nisnit fillimisht ankimin lidhur me këtë shqetësim:

- A) Drejtuesi i institucionit arsimor
- B) Zyra Vendore Arsimore
- C) Drejtoria Rajonale Arsimore
- D) Nga niveli më i ulët institucional dhe vazhdon i përshkallëzuar deri tek niveli më i lartë

PS)D



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KODI

Testimi i kandidatëve për Shërbimin psiko-social në IPAP (Profili Punonjës Social)

E Martë, 14 Dhjetor 2021
Ora 10.00

Për t'u plotësuar nga Komisioni i Vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikë										

Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikë										

Pyetja	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
Pikë										

Pyetja	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
Pikë										

Rubrika	Nr. i pikëve sipas rubrikave	Pikë të fituara
Me alternativa (40pyetje*1 pikë)	40	
Totali	40	

Komisioni i vlerësimit (Emri, Mbiemri, Firma)

Pyetja 1

Punonjësi social duhet të marrë miratimin me shkrim të prindërve, kur realizon me nxënësit:

- A) Fokus grup
- B) Bisedë të hapur
- C) Ndërhyrje psiko-sociale
- D) Anketë

PS)C

Pyetja 2

Punonjësi social në institucionin arsimor nuk ka funksion:

- A) Të udhëzojë mësuesit për hartimin e planit edukativ individual
- B) Të hartojë planin edukativ individual
- C) Të ndihmojë mësuesit për zbatimin e planit edukativ individual
- D) Të ndjekë ecurinë e nxënësve me aftësi të kufizuar

PS)B

Pyetja 3

Zhvillimi i brendshëm profesional për shërbimin psiko-social ofrohet nga:

- A) Drejtuesi i shkollës
- B) Ekipi kurrikular
- C) Organizata jofitimprurëse
- D) Njësia e shërbimit psiko-social

PS)D

Pyetja 4

Profesionisti në ushtrimin e detyrës së tij ka detyrë:

- A) Të respektojë ligjet dhe kodin etik të profesionit
- B) Të mbajë sekret titullin e profesionit të tij
- C) Të mos përditësojë aftësitë profesionale
- D) Të mos të japë të dhëna për përvojën e tij profesionale

PS)A

Pyetja 5

Dosjet e nxënësve të hartuara nga punonjësi social ruhen në institucionin arsimor:

- A) 1 vit
- B) 2 vite
- C) 3 vite
- D) 4 vite

PS)D

Pyetja 6

Referuar ligjit të arsimit parauniversitar qendrat kulturore të fëmijëve janë:

- A) Institucione sportive
- B) Institucione shoqërore
- C) Institucione plotësuese
- D) Institucione rehabilituese

PS)C

Pyetja 7

Në komisionin e nxënësve me aftësi të kufizuar të institucionit arsimor nuk merr pjesë:

- A) Drejtori i shkollës
- B) Mësuesi i fushave të ndryshme të të nxënësve
- C) Mësuesi ndihmës
- D) Punonjësi i shërbimit psiko-social

PS)A

Pyetja 8

Masat disiplinore të lehta për nxënësit jepen nga:

- A) Mësuesi
- B) Komisioni i disiplinës
- C) Drejtori i shkollës
- D) Komisioni i etikës dhe sjelljes

PS)A

Pyetja 9

Shkolla qendër komunitare ofron veprimtari për:

- A) Zhvillimin e komunitetit
- B) Zhvillimin e institucioneve kulturore
- C) Zhvillimin kulturor, artistik dhe sportiv të mësuesve

D) Zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë

PS)A

Pyetja 10

Në zbatim të ligjit “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” fëmija ka detyrim të ndjekë:

- A) Arsimin parashkollor
- B) Arsimin bazë
- C) Arsimin profesional
- D) Gjimnazin

PS)B

Pyetja 11

Komisioni i disiplinës në institucionin arsimor përbëhet nga:

- A) Sekretari i shkollës, punonjësi i shërbimit psiko-social, nxënës
- B) Nëndrejtori, oficeri i sigurisë, mësues
- C) Drejtori i shkollës, nëndrejtori, mësues
- D) Prindër, mësues, nxënës

PS)C

Pyetje 12

Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës:

- A) 0-3 vjeç
- B) 2-5 vjeç
- C) 3-6 vjeç
- D) 5-6 vjeç

PS)C

Pyetje 13

Shkolla qendër komunitare ka vendosur të verë në dispozicion të komunitetit palestrën e saj. Në këtë rast shkolla ofron për komunitetin:

- A) Ndihmë financiare
- B) Ndihmë psikologjike
- C) Burimet e saj
- D) Ndihmë materiale

PS)C

Pyetje 14

Numri i nxënësve për punonjësin social në institucionin arsimor përcaktohet në:

- A) Urdhrin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- B) Urdhrin e Njësisë së Shërbimit Psiko-social
- C) Urdhrin e Zyrës Vendore Arsimore
- D) Urdhrin e Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore Parauniversitare

PS)A

Pyetja 15

Fëmijët refugjatë në Shqipëri kanë të drejtë të ndjekin:

- A) Arsimin parashkollor
- B) Arsimin bazë
- C) Arsimin e mesëm
- D) Të gjitha nivelet arsimore

PS)D

Pyetja 16

Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet medalje ari nga:

- A) Presidenti
- B) Kryeministri
- C) Ministri
- D) Drejtori i shkollës

PS)B

Pyetje 17

Licencimi i shkollave private që zhvillojnë mësim edhe në gjuhë të huaj bëhet:

- A) Me vendim të Ministrisë
- B) Me vendim të Kryeministrit
- C) Me vendim të Këshillit të Ministrave
- D) Nga Qendra Kombëtare e Licencimit

PS)C

Pyetja 18

Përmes përdorimit të manualit të Punës për Punonjësit e Njësisë së Shërbimit Psiko-Social në Shkollë NUK synohet që çdo punonjës social të jetë në gjendje:

- A) Të punoj për fuqizimin dhe adresimin e nevojave të familjes së nxënësve të shkollës
- B) Të planifikojë dhe ofrojë shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve,
- C) Të kombinojë punën me rastet individuale me ndërhyrjet në grupe dhe komunitetin shkollor
- D) Të identifikojë dhe vlerësojë rastet e nxënësve me probleme sociale, emocionale, të të nxënësve dhe të sjelljes

PS)A

Pyetja 19

Aplikimi i modelit biopsiko-social në praktikën klinike, kërkon që punonjësit socialë në sistemin arsimor:

- A) Të thellohen në historinë e klientit në kontekstin e rrethanave të jetës së tij;
- B) Të vendosin se cilat aspekte të fushave biologjike, psikologjike dhe sociale janë më të rëndësishme për të kuptuar dhe promovuar shëndetin e individit;
- C) Të sigurojnë një trajtim shumëdimensional të tij.
- D) Të gjitha sa më sipër

PS)D

Pyetja 20

Bullizmi NUK përfshin:

- A) Neglizhimin
- B) Dhunën verbale
- C) Dhunën psikologjike
- D) Dhunën fizike

PS)A

Pyetja 21

Anëtar i Komisionit Institucional Arsimor për Nevojat e Aftësisë së Kufizuar pranë institucionit shkollor NUK është:

- A) Mësuesi i lëndës
- B) Mësuesi ndihmës
- C) Drejtuesi i shkollës
- D) Prindi/kujdestari ligjor i fëmijës

PS)C

Pyetja 22

Reagimi i gjithësecilit në situata të fatkeqësive natyrore varet nga:

- A) Natyra dhe ashpërsia e ngjarjes që përjetohet;
- B) Përvoja e tyre me ngjarjet e mëparshme shqetësuese;
- C) Mbështetja nga të tjerët;
- D) Të gjitha sa më sipër

PS)D

Pyetja 23

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, NUK mbështet në parimin:

- A) Garantimit të aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimin të pengesave të të gjitha llojeve
- B) Trajtimin të specializuar në institucione të veçanta të PAK
- C) Mosdikriminimit, i cili garanton që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar
- D) Barazisë, përfshirë barazinë gjinore

PS)B

Pyetja 24

Në dokumentin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, qëllimi strategjik në fushën e arsimit parashikon:

- A) Aksesueshmërinë e transportit publik për çdo individ
- B) Sigurimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara
- C) Garantimin e aksesit në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara
- D) Lehtësimin e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

PS)B

Pyetja 25

Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga:

- A) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve
- B) Punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës
- C) Çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private
- D) Punonjësi i policisë

PS)C

Pyetja 26

Misioni i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është:

- A) Zhdukja e ekstremizmit të dhunshëm
- B) Zgjerimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor shqiptar
- C) Forcimi i kapaciteteve të aktorëve në fusha të ndryshme
- D) Ruajtja e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe të mbrojtjes së shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

PS)D

Pyetja 27

Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020, shkolla NUK duhet të:

- A) Përmirësoj njohuritë rreth identitetit rom dhe egjiptian
- B) Rrisi kapacitetet për mësimdhënie dhe menaxhimin e tij në një mjedis shumëkulturore
- C) Të segregoj/ndaj nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian në klasa dhe grupe të veçanta
- D) Bashkëpunoj me shërbimet sociale lokale dhe aktorë të tjerë të domosdoshëm për adresimin e problemeve sociale

PS)C

Pyetja 28

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, NUK mbështet në parimin:

- A) Diskriminimit pozitiv për fuqizimin e grupeve të komunitetit rom dhe egjiptian
- B) Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm
- C) Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor
- D) Përdorimi i një qasje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit

PS)A

Pyetja 29

Grupi teknik, ndërsektorial, gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duhet të kujdeset që të zbatohen këto parime:

- A) Ruajtja e fshehtësisë dhe konfidencialitetit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje në trajtim
- B) Respektimi i vlerave kulturore e tradicionale të fëmijës dhe familjes së tij/saj, pa cenuar sigurinë, të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës
- C) Ndërtimi i partneritetit me familjen e fëmijës në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve që lidhen me fëmijën në nevojë për mbrojtje
- D) Të gjitha sa më sipër

PS)D

Pyetja 30

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014–2020, NUK mbështet në parimin:

- A) Sigurimit të cilësisë së arritjeve sipas standardeve
- B) Pëlqimit të informuar
- C) Llogaridhënies dhe transparencës
- D) Mbështetjse komunitare

PS)B

Pyetja 31

Rekomandimin për nxënësit e shkollave të arsimit special që duan të kalojnë në shkollat e arsimit bazë e jep:

- A) Komisioni multidisiplinar
- B) Drejtori i shkollës pritëse
- C) Drejtori i shkollës të arsimit special
- D) Komisioni institucional

PS)A

Pyetja 32

Nëse fëmija me aftësi të kufizuar ka nevojë të mësojë me plan edukativ individual përcaktohet nga:

- A) Drejtori i institucionit arsimor
- B) Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore
- C) Komisioni institucional për nxënësit me aftësi të kufizuar
- D) Komisioni multidisiplinar pranë zyrës arsimore vendore

PS)D

Pyetja 33

Nxënësi është mbetës në klasë kur:

- A) Është jo kalues në më shumë se 1 lëndë në sesionin e parë
- B) Është jo kalues në më shumë se 1 lëndë në sesionin e dytë
- C) Është jo kalues në më shumë se 2 lëndë në sesionin e parë
- D) Është jo kalues në më shumë se 2 lëndë në sesionin e dytë

PS)B

Pyetja 34

Karakteristikë e shkollës qendër komunitare është:

- A) Të ofrojë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor për nxënësit
- B) Të ofrojë shërbim për institucionet shtetërore
- C) Të mbështetet mbi pikat e dobëta të komunitetit
- D) Të ofrojë një sërë shërbimesh, përgjatë orarit mësimor

PS)A

Pyetja 35

Të drejtën për të zgjedhur personin që do të përfaqësojë nxënësin në komisionin e disiplinës e ka:

- A) Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore
- B) Mësuesi kujdestar
- C) Drejtori i shkollës
- D) Punonjësi social

PS)A

Pyetja 36

Bordi i institucionit arsimor ka detyrë:

- A) Të miratojë kurrikulën zyrtare
- B) Të miratojë datën e fillimit të vitit shkollor
- C) Të miratojë fondet publike
- D) Të miratojë planin afatmesëm

PS)D

Pyetja 37

Parim i Shkollës Qendër Komunitare është:

- A) Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo anëtar të komunitetit
- B) Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
- C) Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë
- D) Përdorimi i burimeve të institucioneve në varësi të ministrisë

PS)B

Pyetja 38

Nxënësi i klasës V-të ju tregon se mësuesi i matematikës e fyer sa herë ai nuk përgjigjet saktë. Çfarë do të bëni ju?

- A) Do ta drejtoni nxënësin tek mësuesi kujdestar
- B) Do paraqisni rastin në komisionin e etikës dhe sjelljes
- C) Do të njoftoni drejtorin e shkollës
- D) Do të njoftoni oficerin e sigurisë

PS)C

Pyetja 39

Një mësues që jep mësim në klasën e VIII-të ka konstatuar se, një nxënës ushtron dhunë psikologjike karshi një nxënësi tjetër. Ai ka njoftuar drejtorin e institucionit arsimor. Këto raste duhet të trajtohen nga:

- A) Drejtori dhe nëndrejtori
- B) Punonjësi i shërbimit psiko-social dhe oficeri i sigurisë
- C) Bordi i shkollës dhe këshilli i mësuesve
- D) Drejtori i shkollës dhe punonjësi i shërbimit psiko-social

PS)B

Pyetja 40

Në zbatim të parimit “Interesi më i lartë i fëmijës” profesionisti ka parasysh:

- A) Aftësinë e familjes për t’iu përgjigjur nevojave për zhvillim ekonomik, social dhe shoqëror
- B) Mendimin e fëmijës, pavarësisht moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar
- C) Vazhdimësia e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje shoqërore
- D) Aftësinë e shkollës për mirërritjen e fëmijës dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tij

PS)C